

## PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT: Instalimi i sistemit te ngrohjes shkolla “Ernest Koliqi” Shirokë, Faza II.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Instalime kaldajash.

**VLERA E FONDIT LIMIT: 907,378** (Nenteqind e shtate mije e treqind e shtatedhete e tete) **lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Shkodër** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:
  - a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
  - b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin76”Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbështetje te Nenit 26”Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin përmbledhës te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Përmbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.*

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

*Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 8.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”si dhe si dhe ne Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, te ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019-2020-2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht **362,951** (treqind e gjashtedhete e dy mijë e nentëqind e pesëdhjetë e nje) lekë.

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

---

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”*”Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”*, si dhe bazuar ne nenin 43, pika 2/c, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.* .

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **362,951** (treqind e gjashtedhjetë e dy mijë e nentëqind e pesëdhjetë e një) lekë.

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare) që është 40% e vlerës së fondit limit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.” pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2022 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2022.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Megjese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrorjnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **30%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **272,213** (dyqind e shtatedhjete e dy mijë e dyqind e trembedhjete) lekë pa TVSH dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se sa vlera limit e kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **907,378** (nenteqind e shtate mijë e treqind e shtatedhjete e tete) lekë.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
  - Kontratë Sipërmarrje
  - Situacionin përfundimtar;
  - Aktin e kolaudimit;
  - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Kontrate Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Akt kolaudimi objekti;
  - Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
  - Fature tatimore perkatëse.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4. në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njëzore të teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të pershtatshëm cilësor. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të pershtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”...Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: a) Për kontratat e punëve:

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat **30%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose **vlera limit e**

**kontratës që prokurohet**, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulet monetar, punët e mëparshme të ngjashme janë minimalisht në vlerat **30%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose **vlera limit e kontratës që prokurohet**, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar dhe përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmerinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39, pika 8 *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Sipas këtij neni, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), „, Udhezimi i K.M nr.2 ,datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Udhezimin Nr.3 datë 15.02.2001 ”Për Mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit “ të ndryshuar, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës për të vertetuar kërkesat e përcaktuara në nenin 39 pika 5/a dhe b, duhet të paraqesin Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, kontratat e sipërmarrjes , situacionet përfundimtarë, aktin e kolaudimit, Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim për punët e kryera me entet publike, që Autoriteti Kontraktor të bindet që operatori ekonomik me anë të dokumentacionit të paraqitur plotëson kriterin për punë të ngjashme ku shihen zërat e punimeve që ka realizuar , koha e realizimit , dokumentacioni i kolaudimit dhe marrjes në dorezim të objektit si dhe vleresimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktor,elemente të nevojshme për të gjykuar për plotësimin e kriterëve për punë të ngjashme.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

**Punime të përgjithshme ndërtimi:**

Kategoria NP-3 Niveli A “Rikonstruksioni m/m godina ...”

**Punime speciale ndërtimi:**

Kategoria NS-1 Niveli A “Punime për prishjen e ndertimeve ...”

Kategoria NS-12 Niveli A “Impiante teknologjik dhe të kondicionimit”

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane..” Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:**

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë e respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
<u>Kategoria NP-3</u>	Rik dhe M/M e godinave civile dhe industriale	punimeve sipas zerave te preventivit	Niveli A	235,542 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-1</u>	Punime per prishjen e ndertimeve	Punimet sipas zerave te preventivit	Niveli A	28,575 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-12</u>	Impiante teknologjik dhe te kondicionimit	Punimet sipas zerave te preventivit	Niveli A	110,338 leke pa tvsh

**2.3.3.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

**a. 1(nje)inxhinier mekanik**

Inxhinieri i mësipërm duhet të jenë të i siguruar dhe të figurojë me kohë të plotë në listëpagesat perkatese E-Sig për të paktën **muajin e fundit**

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kontratën individuale të punës, Diplomën e inxhinierit të mësipërm.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**2.3.4** Vetdeklarimin nga inxhinieri mekanik se është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

*Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar ne [Rekomandimin Nr. 6732 date 21.10.2020](#)”Mbi Problematikat e konstatuara gjate monitorimit nga APP”*

**2.3.5 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë me profesion inxhinier mekanik dhe të deklaroje se ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.**



***Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor***

***Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” ne nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar***

Eshtë kërkuar inxhinier mekanik për zbatimin e punimeve ne perputhje me zerat e punimeve te preventivit ,projektit, specifikimeve teknike qe do te zbatohen dhe si dhe kategorive perkatese ne licencen perkatese te zbatimit,Inxhinieri Mekanik është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve.Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve qe vendosen ne objekt .

**2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjesve të siguruar për muajin e fundit duhet te jetë 5 (pese).**

Lidhur me këte pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetsore në të cilin të jetë i percaktuar numri i punonjesve të siguruar për periudhen e mësipërme, shoqëruar me listepagesat perkatese E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shëndetsore.

***Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.***

***Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të***

Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Numri i punonjesve 5.

Afati 2 (dy) muaj.

Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte  $714:8=89:44=2.02$  puntore

Nevojiten:

1- Mekaniku nevojitet per kryerjen e punimeve ne objekt Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte  $316:8=40:44=0.9$  mekanike

2- Muratori nevojitet per kryerjen e punimeve te ndryshme te ndertimit .Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte  $166:8=21:44=0.47$  puntore

3-Hidrauliku nevojitet per kryerjen e punimeve hidraulike.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte  $232:8=29:44=0.65$  puntore

4-Teknik 1 punonjes

5-Shofer 1 punonjes

Totali 5 punonjes

Ne lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve kjo kerkese eshte e mbështetur në Nenin 39, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes të pasqyruar në listëpagesa për të paktën **muajin e fundit**, te paisur me kontrate pune (te vlefshme), me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të leshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë, ku nga këta të jenë të paktën:

Mekanik	1 (nje) punonjës
Murator	1 (një) punonjës
Hidraulik	1(nje) punonjes

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

1- Mekaniku nevojitet për kryerjen e punimeve në objekt Sasia e oreve të punës sipas manualit është  $316:8=40:44=0.9$  mekanike

2- Muratori nevojitet për kryerjen e punimeve të ndryshme të ndërtimit .Sasia e oreve të punës sipas manualit është  $166:8=21:44=0.47$  puntore

3-Hidrauliku nevojitet për kryerjen e punimeve hidraulike.Sasia e oreve të punës sipas manualit është  $232:8=29:44=0.65$  puntore

4-Teknik 1 punonjes

5-Shofer 1 punonjes

Totali 5 punonjes

Vendosja e katër kriterëve për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në si dhe mjeteve të kerkuara për zbatimin me sukses të kesaj kontrate.

Kerkesa që punonjësit e me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të leshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë është bërë bazuar duke vlerësuar se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deshmi për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme sipas dispozitave të ligjit nr.8734, datë 1.2.2001 për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” i ndryshuar.

**2.3.8** Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun ose fragmente të katalogut të prodhuesit, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen sipas materialeve të kerkuara nga AK në specifikimet teknike. (Fotot janë thjeshtë orientuese dhe ilustruese)

Pjesët e katalogut të prodhuesit ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve duhet të jenë të përkthyer në shqip.

**Shënim:** *Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë e katalogut, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.*

**2.3.9** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim të prodhuesit/ Distributorit të autorizuar për elementet e mesipër. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim distributori operatori ekonomik ta vërtetojë këtë duke paraqitur kontratë premtimi, letër angazhimi/akt-marreveshje lidhur mes Kompanisë prodhuese dhe Distributorit të autorizuar.

**Argumentimi:** Bazuar në nenin 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, duke patur parasysh se në zërat kryesore të preventivit

parashikohet furnizimi me paisje dhe instalimi i tyre që përbëjnë edhe vlerën me të madhe të preventivit , ne menyre qe AK te verifikoje qe specifikimet teknike te paisjeve te propozuara nga operatoret ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike te përcaktuara në dokumentat e tenderit , duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: Autorizim prodhuesi ose distributorin, katalogët ose pjesë të tyre, me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

**2.3.10** Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit:

Nr	Mjetet	Sasia
1	Mjet transporti veteshkarkues deri 5 ton (kapac.mbajtes)	1 copë
2	Aparat saldimi CP3	1 copë
3	Aparat saldimi me gaz CP5	1 copë
4	Matrapik	1 copë
5	Betoniere	1 copë
6	Skeleri	100 m <sup>2</sup>
7	Pompe uji	0.5 m <sup>3</sup>
8	Kthyes tubacioni	1 cope

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike operatori duhet të paraqesë:

- i. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme).
- ii. Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqiperisë ose faturat tatimore te blerjes.
- iii. Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.
- iv. Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne rregjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Periudha e garancise per defektet eshte 2 vjet pas marrjes ne dorezim te objektit (hartimit te procesverbalit te marrjes ne dorezim dhe certifikates)

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës.

### **Mjet transporti vetshkarkues deri në 5 ton (ngarkesa)**

Transport material të ndryshme -15 ton

Totali 15 ton : 44=0,3 ton, mesatarisht 1 rrugë në ditë

### **Argumentimi i specifikimeve teknike:**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*